



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNA E RAHOVECIT PËR VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komuna e Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komuna e Rahovecit (KR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komuna e Rahovecit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komuna e Rahovecit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Parregullsi në procedurat e prokurimit publik.
- A2 Kosto shtesë si rezultat i pagesave nga vendimet gjyqësore / përmbartimore.
- B1 Regjistrimi i urdhërblërjeve në SIMFK pas pranimit të faturave.
- B2 Vonesa në pagesën e obligimeve financiare.
- B3 Garancioni i punimeve jo në afatin e përcaktuar me kontratë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i Financave është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Financave është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komuna e Rahovecit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komuna e Rahovecit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komuna e Rahovecit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komuna e Rahovecit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komuna e Rahovecit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Fushat që kërkojnë përmirësim kryesisht janë: prokurimi publik dhe menaxhimi i kontratave publike, realizimi me kohë i projekteve kapitale, klasifikimi i shpenzimeve në kategori përkatëse, mospagesa e obligimeve brenda afatit kohor ligjor, etj. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, katër (4) të përsëritura, dhe një (1) rekomandim pjesërisht i zbatuar.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Parregullsi në procedurat e prokurimit publik

Gjetja

Në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë përcaktohen kriteret që duhet të plotësohen nga ofertuesit për të fituar kontratë publike. Me kushtet e veçanta të kontratës përcaktohet vlera (përqindja) dhe afati kohor i sigurisë së ekzekutimit të kontratës. Siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmbushjen e kontratës dhe është parakusht për nënshkrim dhe hyrje në fuqi të kontratës. Neni 36 i LMFP përcakton që para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, OB i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në SIMFK. Gjithashtu, pika 70.10 e Rregullores 001/2022 për prokurimin publik, përcakton se pas pranimit të njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i kontratës duhet të kyçet në sistem të prokurimit elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të kontratës. Si fazë e parë menaxheri i kontratës duhet të krijojë planin për menaxhimin e kontratës.

Parregullsitë e hasura të procedura e prokurimit Ndërtimi i rrugës në Rahovec nga rreth-rrrotullimi deri në dalje të rrugës për Xërxë, në vlerë 1,222,222€, janë:

- Në njoftimin për kontratë ishin kërkuar që kopjet e noterizuara të diplomave për stafin profesional, të prezantohen nga vet inxhinierët të noterit. Noterizimi i dokumenteve nuk ishte bërë nga vetë inxhinierët para noterit, por nga përfaqësuesi i kompanisë. Gjithashtu, noterizimi i diplomës për menaxherin e projektit, nuk ishte bërë nga dokumenti origjinal, por nga kopja e zakonshme, dhe noterit në shkresën e tij konfirmon se dokumenti origjinal nuk i është prezantuar.
- OE që ka fituar këtë tender, ka ofruar për menaxherin e projektit referencë për përvojën e punës 4 vjeçare, por në CV-në e nënshkruar nga inxhinieri, nuk prezantohet se ka përvojë pune të kjo kompani. Në njoftim për kontratë ishte kërkuar që menaxheri të ketë së paku 7 vite përvojë pune, referencat e punës nga punëdhënësit, dhe CV të jetë e nënshkruar nga inxhinieri.
- Çertifikatat ISO 9001-2015, ISO 14001-2015, dhe ISO 45001-2018, ishin kërkuar kopje nga origjinali, ndërsa janë ofruar të noterizuara nga kopja e zakonshme. Noterit në shkresat e tij, konfirmon se dokumenti origjinal nuk i është prezantuar.
- Me njoftimin për kontratë është kërkuar që plani i menaxhimit të trafikut të jetë i nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit. Planin e menaxhimit që e ka ofruar kompania është vënë vetëm nënshkrimi, por je edhe emri dhe mbiemri për të përcaktuar se është nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit. Kontraktuesi nuk kishte dëshmi në ofertën e tij që ka inxhinier të komunikacionit.

Parregullsitë e hasura të procedura e prokurimit Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit, në vlerë 272,350€, janë:

- OE me çmimin më të lirë të ofertuar prej 243,020€, ishte eliminuar nga procesi i prokurimit me arsyen se kishte ofruar listën e

panëshkruar dhe të pavulosur të projekteve të realizuara. Megjithatë, OE që është eliminuar kishte ngarkuar në ofertën elektronike në sistemin e-prokurimi listën e nënshkruar dhe të vulosur të projekteve të realizuara.

- Fituesi i tenderit ka ofruar sigurinë e ekzekutimit të kontratës me afat të vlefshmërisë dy muaj më pak se sa është kërkuar me kushtet e veçanta të kontratës.
- Nuk ishte përgatitur plani për menaxhimin e kontratës.

Te procedura e prokurimit Ndërtimi i sheshit qendror të qytetit, në vlerë 3,817,348€, siguria e ekzekutimit të kontratës në vlerë 381,734€ ishte bërë për afatin 365 ditë, e jo për 990 ditë, si është kërkuar me kushtet e veçanta të kontratës.

Te procedura e prokurimit Ndërtimi i objektit të SH.F.M.U "Hamëz Thaqi" në Xërxë, në vlerë 1,575,679€, siguria e ekzekutimit në vlerë 157,567€ ishte bërë për afatin 365 ditë, e jo për 510 ditë, si është kërkuar me kushtet e veçanta të kontratës.

Për kontratën publike Furnizimi i shkollave me teknologji informative - tabela digjitale, në vlerë 54,700€, zotimi i mjeteve në SIMFK ishte bërë 2 muaj pas nënshkrimit të kontratës, dhe se nuk ishte përgatitur plani për menaxhimin e kontratës.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mbikëqyrjes dhe kontroleve të pamjaftueshme në procedurat e prokurimit, në procesin e vlerësimit të tenderëve, dhe pakujdesia e menaxherëve të kontratës.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuara mund të ndikojnë që kontraktuesit të mos jenë të përgjegjshëm dhe të mos kenë kapacitetet e duhura profesionale në realizimin e projekteve të kontraktuara, të përzgjidhen oferta me çmim më të lartë, Në mungesë të zotimit të mjeteve dhe mos përgatitjes së planit për menaxhim kontratat mund të mos realizohen me kohë dhe si duhet.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i tenderëve nga komisionet e vlerësimit bëhet në pajtim me kërkesat e përcaktuara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Kontratat publike të mos nënshkruhen pa zotim paraprak të mjeteve në SIMFK dhe pa siguri të ekzekutimit në afatin e përcaktuar. Planet e menaxhimi të përgatiten menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Kosto shtesë për shkak të pagesave përmes vendimeve gjyqësore / përbarimore

Gjetja

Neni 40.1 i LMFPP, përcakton që kur një gjykatë nxjerr urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrin ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.

Si pasojë e pagesave nga vendimet gjyqësore/përbarimore, Komuna e

Rahovecit ka paguar në emër të kamatave dhe procedurave të përmbartimit vlerën prej 71,479€. Në total pagesat përfshirë borxhin kryesor dhe kamatat ishin 304,560€. Nga kjo shumë, për paga e mëditje ishin paguar 171,928€, për mallra e shërbime 15,188€, dhe për investime kapitale 117,442€.

Kjo ka ndodhur për shkak të hyrjes në obligime pa zotim paraprak të mjeteve, dobësive në menaxhim të kontratave, paqartësisë ligjore për pagesën e shujtave dhe pagave jubilarë, etj.

Ndikimi Pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve respektivisht implementimin e projekteve, po ashtu krijojnë kosto shtesë në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe interesit.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet që kanë rezultuar me mos pagesë me kohë të obligimeve ndaj kontraktuesve, e të cilat kanë rezultuar me ngritjen e padive dhe procedura gjyqësore / përmbartimore ndaj komunës. Para hyrjes në obligime të sigurohen fondet e nevojshme, si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve dhe në pagesën me kohë të obligimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Urdhërblertet pas pranimit të faturës apo pranimit të furnizimeve dhe punëve

Gjetja Neni 22 i Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF-Shpenzimi i parasë publike, përcakton procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave. Nga kjo, kërkohet që zotimi dhe urdhërblertja ti paraprijë pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve.

Në 8 pagesa për investime kapitale në vlerë totale 316,393€, dhe 11 pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë 111,365€, zotimet dhe urdhërblertet ishin bërë pas pranimit të faturave apo pas pranimit të furnizimeve dhe punimeve. Vonesat në përgatitjen e urdhërblertjeve nga data e pranimit të faturave ishin nga 14 ditë deri 514 ditë.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në përgatitjen e urdhërblertjeve me kohë në SIMFK.

Ndikimi Përgatitja e urdhërblertjeve me vonesë vështirëson zbatimin e drejtë të pagesave/kontratave dhe krijon paqartësi rreth urdhëresave për blertje dhe përcjellës së afatit të liferimit.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që procesit të blertjeve apo porosisë për punë, furnizime dhe shërbime dhe punë të kontraktuara ti paraprijë përgatitja e zotimit dhe aprovimi i urdhërblertjeve në SIMFK.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Vonesa në pagesën e obligimeve financiare

Gjetja LMFPF dhe Rregulla financiare Nr.01/2013/MF për shpenzimin e parave publike, përcakton se, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Nga auditimi i pagesave kemi identifikuar se obligimet ndaj kontraktuesve nuk ishin realizuar brenda afatit ligjor prej 30 ditëve nga data e pranimit të faturës. Kjo është hasur në 28 pagesa për investime kapitale në vlerë 1,143,154€, 16 pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë 128,92€, dhe një pagesë në vlerë 1,864€ nga kategoria e subvencioneve. Vonesat ishin nga 2 javë deri 17 muaj.

Kjo ka ndodhur për shkak të hyrjes në obligime pa zotim paraprak të mjeteve buxhetore.

Ndikimi Mos pagesa me kohë e obligimeve financiare rritë rrezikun e ankesave apo padive të mundshme nga kontraktuesit, dhe kjo mund të shkaktojë kosto shtesë financiare për Komunën.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, dhe se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda afatit kohor ligjor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Garancioni i punimeve jo në afatin e duhur**

Gjetja Me kushtet e veçanta të kontratave publike përcaktohet periudha garantuese e defekteve që kontraktuesit duhet të ofrojnë për sigurinë e kualitetit të punimeve që kanë realizuar.

Për (4) katër kontrata publike, kontraktuesit kishin ofruar sigurinë e kualitetit të punimeve për afatin 1 vjeçar, e jo në afatin 2 vjeçar siç ishte përcaktuar me kushtet e veçanta të kontratës. Kjo është hasur te:

- Projekti Ndërtimi i SHFMU Liria në fshatin Fortesë, me garancion të punimeve në vlerë 83,498€.
- Projekti Meremetimi i rrugëve dhe trotuareve - Lot II, me garancion të punimeve në vlerë 19,376€.
- Projekti Ndërtimi i rrugëve lokale në komunën e Rahovecit - Lot III, me garancion të punimeve në vlerë 27,567€.
- Projekti Ndërtimi i tregut ditor në fshatin Ratkoc, me garancion të punimeve në vlerë 7,000€.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve joadekuate dhe pakujdesisë së kompanisë së kontraktuar për menaxhimin e projekteve kapitale.

Ndikimi Defektet apo dëmtimet e mundshme të punimeve të realizuara mund të mos përmirësohen për periudhën e pa mbuluar me garancionin e punimeve.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave monitorojnë dhe pranojnë nga kontraktuesi garancinë e kualitetit të punimeve në afatin e përcaktuar me kontratë, para se të aprovojnë raportin për pagesën përfundimtare të punimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 360,000€, prej tyre në vitin 2022 ishin shpenzuar 342,704€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me financimin e OJQ-ve për projekte në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, si dhe pagesa për përfitues individual.

Çështja A3 - Ndarje jo e duhur e detyrave

Gjetja Sipas nenit 38 të Rregullores MF-Nr. 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, udhëheqësi përcakton ndarjen e detyrave që ndanë operacionet dhe përgjegjësitë për zbatimin e dy ose më shumë fazave të një procesi ose aktiviteti në mes të punëtorëve të ndryshëm. I njëjti punëtorë nuk mund të jetë përgjegjës njëkohësisht për miratim, zbatim, kontabilitet dhe kontroll.

Në komisionin e vlerësimit të aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për klubet dhe shoqatat sportive dhe OJQ për vitin 2022, një anëtar i komisionit përbëhej nga zyrtari certifikues.

Kjo ka ndodhur për shkak mos veprimit në përputhje me kërkesat ligjore për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi.

Ndikimi Mos ndarja e detyrave dhe përgjegjësi si duhet mund të ketë ndikim në rritjen e rrezikut nga mos kontrolli i duhur, pasi që zyrtari i përfshirë në rolin e vlerësuesit dhe certifikuesit mund të devijon nga realiteti i procesit.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi në pajtim me kërkesat dhe procedurat e MFK-së, ashtu që i njëjti zyrtar të mos marr pjesë në dy apo më shumë faza të procesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,996,784€, prej tyre në vitin 2022 ishin shpenzuar 5,577,441€. Ato kanë të bëjnë me investimet në infrastrukturën rrugore, mirëmbajtjen investive, ujësjellës, rregullimin e lumenjve, parqe, ndërtimin e objekteve shëndetësore, arsimore dhe kulturore, furnizime me pajisje mjekësore, pajisje tjera, etj.

Çështja B4 - Vonesa në realizim të projekteve kapitale

Gjetja Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimit Publik, pikat 61.6, 61.19 dhe 61.20 përcaktojnë se: Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se kontraktuesi kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Gjithashtu, me kushtet e veçanta të kontratës përcaktohet afati kohor i realizimit të projekteve.

Vonesa në realizim të projekteve kapitale janë hasur te kontratat:

- Ndërtimi i objektit të çerdhes së fëmijëve në fshatin Ratkoc, në vlerë 468,298€, e nënshkruar në muajin nëntor 2018, do të duhej të përfundonte brenda dy viteve. Projekti nuk ishte përfunduar deri në fillim të muajit dhjetor 2022.
- Ndërtimi i kanalizimeve në komunën e Rahovecit, në vlerë 441,156€ dhe aneks kontrata në vlerë 40,530€, duhej të përfundonte në fund të vitit 2020, ndërsa ka zgjatur deri në maj 2022.
- Riparimi i monumenteve kulturore - historike, Lot 2, e nënshkruar me datë 20.09.2021, në vlerë 130,016€ ishte planifikuar të realizohej për 430 ditë. Deri në dhjetor 2022 ishin realizuar 36% e punimeve të kontraktuara.
- Ndërtimi i tregut ditor në fshatin Ratkoc, në vlerë 69,997€ është nënshkruar e date 18.06.2021, me afat të realizimit prej 120 ditëve, ishte realizuar me 6 muaj vonesë.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në menaxhimin e kontratave publike dhe mungesës së mjeteve buxhetore.

Ndikimi Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore për buxhetin e vitit pasues. Kjo po ashtu ndikon në performancën dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë se projektet kapitale realizohen brenda planit dinamik të përcaktuar me kontratë, dhe për vonesat e pa arsyetuara të aplikohen penalet e parapara me kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve

Gjetja Me planin kontabël definohet se shpenzimet duhet të regjistrohen në kategoritë adekuate ekonomike. Gjithashtu, Udhëzimi Administrativ Nr. 2005/08 për klasifikimin ekonomik të shpenzimeve përshkruan qartë definicionet e kategorive ekonomike që i përdor Thesari për të regjistruar dhe raportuar shpenzimet.

Pagesa e faturës në vlerë 7,000€ për furnizim me material ndërtimor për renovimin e shtëpive të komuniteteve jo-shumicë, ishte bërë nga kategoria e investimeve kapitale, ndonëse shpenzimi i takon kategorisë së subvencioneve.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos planifikimit të duhur të shpenzimit në kategorinë përkatëse ekonomike.

Ndikimi

Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorisë ekonomike të shpenzimit me ndikim në raportimin financiar, dhe mos pasqyrim i drejtë informacionit për palët e interesit.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen në kategoritë adekuate të buxhetit apo të ri-destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme, dhe që pagesa e shpenzimeve të realizohet nga buxheti i kategorisë adekuate ekonomike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategoritë ekonomike: mallrat dhe shërbimet, subvencionet dhe investimet kapitale

Çështja A4 - Parregullsi në menaxhimin e kontratave publike të kontraktuara përmes procedurës me çmim të poentuar (peshuar)

Gjetja

Siç shpjegohet me pikën 54.15 të Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, Kurdo që Autoriteti kontraktues (AK) nuk dine sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në baze të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo taveni +/- 30%.

Gjithashtu, në shpjegimin nr. 68, të KRPP-së, përcaktohet se AK duhet të luajnë një rol aktiv në përcaktimin sa më të saktë të vlerës së parashikuar e më këtë edhe vlerës së kontratës (të realizuar). Duke pasur parasysh faktin se peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe në rëndësinë e kategorisë përkatëse, kjo nënkupton që edhe sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë, por të ruajnë të njëjtin raport. Funkcioni i vetëm i peshimit të çmimit gjatë kontraktimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët.

Gjatë realizimit të (3) tri kontratave publike me çmim të poentuar, nuk është ruajtur raporti ndërmjet sasisë apo përqindjes së realizuara të kategorisë, dhe peshës apo përqindjes së dhënë gjatë kontraktimit asaj kategorie. Rastet janë hasur te:

- Kontrata publike Hartimi i projekteve të ndryshme, me vlerë totale të parashikuar 350,000€, janë përcaktuar 7 kategori ku secilës kategori i është përcaktuar pesha apo përqindja e shpenzimit. Për kategorinë I.G - Projektimi i urave, mbikalimeve, trotuareve, etj. e peshuar 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës ose 35,000€, vetëm për situacionin e parë të punimeve, për këtë kategori ishin shpenzuar 212,004€ apo 61% e vlerës së përgjithshme të kontratës, duke tejkaluar me 51% vlerën e parashikuar. Kjo kategori kishte çmimin më të lartë 3.08€ të peshuar në krahasim me kategoritë tjera (0.11€, 0.13€, 0.16€, 0.12€, 1.73€). Kontrata është fituar nga OE që ka ofruar çmimin e peshuar më të ulët, përderisa realizimi i 61% të kontratës është bërë për kategorinë me çmimin më të lartë.
- Kontrata publike, Mbikëqyrja e investimeve kapitale, në vlerë totale të parashikuar 80,000€, ishte kontraktuar bazuar në çmimin për njësi dhe duke përcaktuar rëndësinë dhe peshën (%) e dhënë për secilën kategori/pozicion. Paramasa apo specifikacioni teknik ishte ndarë në pesë kategori kryesore, të peshuara me përqindje sipas shpenzimit. Për kategorinë E - projekte të objekteve ndërtimore të ndryshme, e peshuar 10% e vlerës së përgjithshme të kontratës ose 8,000€, ishin shpenzuar 62,085€ apo 78% e vlerës së përgjithshme të kontratës.
- Kontrata publike, Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve, në vlerë totale të parashikuar 150,000€, ishte kontraktuar bazuar në çmimin për njësi dhe duke përcaktuar rëndësinë dhe peshën (%) e dhënë për secilën kategori/pozicion. Paramasa apo specifikacioni teknik ishte ndarë në pesë kategori kryesore, të peshuara me përqindje sipas

shpenzimit. Për kategorinë 1 - shenjzime horizontale të komunikacionit, e peshuar 22% e vlerës së përgjithshme të kontratës ose 33,000€, ishin shpenzuar 84,623€ apo 56% e vlerës së përgjithshme të kontratës.

Gjithashtu, këto kontrata gabimisht ishin konsideruar kontrata publike kornizë, ku devijimi i lejuar është përcaktuar +/- 30%, ndonëse te kontratat publike me peshim nuk vlen pragu +/- 30%

Kjo kishte ndodhur për shkak të planifikimit të dobët të nevojave nga njësia kërkuese dhe mungesës së kontrolleve adekuate në menaxhimin e kontratave.

Ndikimi

Ndryshimi i raportit të peshimit apo përqindjes mes planifikimit dhe pagesave ndikon në mos realizim të kategorive tjera të kontraktuara. Devijimi nga përqindja apo pesha e kontraktuar gjatë realizimit të kontratës shkakton kosto më të lartë nga ajo e kontraktuar, për shkak se raporti i peshimit është faktor kryesor në përzgjedhjen e tenderit apo ofertës më të lirë gjatë procedurës së prokurimit.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë se te kontratat publike të kontraktuara përmes procedurës me çmim të peshuar, raporti i peshimit apo përqindjes së përcaktuar për kategoritë të jetë i njëjtë edhe gjatë realizimit përkatësisht pagesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	15,053,659	16,466,107	15,648,597	15,041,586	15,129,427
Grante Qeveritare - Buxheti	13,703,111	13,712,447	13,217,112	13,193,192	13,743,871
Financimi përmes huamarrjes	0	102,049	102,049	46,852	100,020
Të bartura nga viti i kaluar	0	592,277	534,009	452,593	309,043
Të hyrat vetanake	1,350,548	1,350,548	1,167,754	937,785	974,370
Donacionet vendore	0	10,607	9,973	4,177	2,123
Donacionet e jashtme	0	698,179	617,701	406,988	0

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,412,448€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme në vlerë 708,786€, të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 592,277€, financimeve nga huamarrja në vlerë 102,049€, dhe ndryshimit përmes vendimit të qeverisë në vlerë 9,336€.

Në vitin 2022 Komuna e Rahovecit ka shpenzuar 95% të buxhetit përfundimtar ose 15,648,597€, me një ulje prej 4% në krahasim me vitin 2021. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Gjithashtu, në vitin 2022 Komuna e Rahovecit ka përfituar 287,768€ të hyra nga gjobat në trafik, 44,390€ të hyra nga gjobat e gjykatave, dhe 620€ të hyra nga Agjencia e Pyjeve. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe i inkasojnë institucionet përkatëse, ndërsa Komunës së Rahovecit i alokohen në baza tremujore gjatë vitit për realizim të pagesave.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	15,053,659	16,466,107	15,648,597	15,041,586	15,129,427
Pagat dhe mëditjet	7,872,843	7,984,228	7,610,165	7,602,730	7,716,523
Mallrat dhe shërbimet	1,735,000	1,855,094	1,848,923	1,721,164	1,664,862
Komunalitë	270,000	270,000	269,364	280,322	263,830
Subvencionet dhe transferet	360,000	360,000	342,704	476,200	320,532
Investimet Kapitale	4,125,816	5,996,784	5,577,441	4,961,170	5,163,679
Rezervat	690,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti për Paga e Mëditje është rritur për 111,385€. Rritja është rezultat i pranimeve nga financimet e huamarrjeve në shumë 102,049€ dhe vendimit të qeverisë në vlerë 9,336€, me qëllim rimëkëmbjen ekonomike të dedikuara për sektorin e shëndetësisë.
- Buxheti i Mallrave dhe Shërbimeve është rritur për 120,094€. Rritja është ndikuar nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar në vlerë 120,000€, dhe donacioneve në vlerë 94€.
- Buxheti për Shërbime Komunale gjatë vitit 2022 ka mbetur i pandryshuar.
- Buxheti për Subvencione dhe Transfere gjatë vitit 2022 ka mbetur i pandryshuar.
- Buxheti për Investime kapitale është rritur për 1,870,968€. Rritja është ndikuar nga donacionet në vlerë 708,692€, transferi i buxhetit të kategorisë së Rezervave në Investime Kapitale vlerë 690,000€, dhe nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar në shumë 472,277€. Programi i investimeve publike përfshin 58 projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe 11 projekte të reja për vitin aktual.
- Buxheti fillestar i Rezervave në vlerë 690,000€, me vendim të qeverisë është transferuar i tëri në buxhetin e kategorisë së investimeve kapitale.

Komuna e Rahovecit ka përfituar nga programi i rimëkëmbjes ekonomike mjete në vlerë 111,385€, të cilat janë shfrytëzuar për financimin e pagave dhe mëditjeve për shërbimet e përgjithshme mjekësore.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Rahovecit në vitin 2022 ishin 1,256,364€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, participimet, qiraja, të hyrat nga veprimtaritë e bizneseve, taksat administrative, dhe taksat tjera komunale.

Gjithashtu, në vitin 2022 Komuna e Rahovecit ka përfituar 287,768€ të hyra nga gjobot në trafik, 44,390€ nga gjobot e gjykatave, dhe 620€ të hyra nga Agjencia e Pyjeve. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe i inkasojnë institucionet përkatëse, ndërsa Komunës së Rahovecit i alokohen në baza tremujore gjatë vitit për tu shpenzuar.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	1,350,548	1,350,548	1,278,159	1,174,111	1,182,723
Të hyrat tatimore	702,117	702,117	498,731	577,233	456,977
Të hyrat jo tatimore	648,431	648,431	757,632	595,406	725,746
Të hyrat tjera	0	0	21,795	1,472	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 të Komunës së Rahovecit ka rezultuar me 14 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna, si dhe ka përgatitur raportet periodike lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2021. Raporti i auditimit për vitin 2021 si dhe plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është diskutuar në kuvendin komunal.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, nëntë (9) rekomandime janë zbatuar, një (1) ishte në proces të zbatimit dhe katër (4) rekomandime nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë, që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ri destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuate.	Keqklasifikim të shpenzimit ka pasur edhe këtë vit, por në vlerë jo materiale.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë, që iniciimi i aktiviteteteve të prokurimit bëhet në kohë dhe përdorim të duhur të procedurave të prokurimit.	Nuk ka pasur ndonjë çështje si në vitin e kaluar.	I zbatuar

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë, që Komisioni për vlerësim të aplikacioneve dhe përzgjedhje të përfituesve të subvencioneve të sportit, të zbatojë të gjitha kriteret e parapara në thirrjen publike dhe në asnjë rast mos të tejkalohet pa u vërtetuar se dëshmitë janë valide me theks të veçantë të vërtetimit për shlyerjen e borxheve ndaj Administratës Tatimore.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë një koordinim më të mirë ndërmjet Komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të të dhënave në bazën e të dhënave. Po ashtu, Kryetari të sigurojë rritjen e kontroleve në mënyrë që të bëhet vlerësimi i saktë i pronave të tatimpaguesve.	Janë ndërmarrë veprime dhe është trajtuar çështja.	I zbatuar
5.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim më të mirë në mes të tatim-paguesve, departamentit të Tatimit në Pronë-Komunës dhe departamentit të Tatimit në Pronë-Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në bazën për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabimi tjetër eventual.	Janë ndërmarrë veprime dhe në bashkëpunim me MF është trajtuar çështja.	I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari duhet të iniciojë një rishikim të zbatimit të kësaj kontrate për të siguruar se ajo po zbatohet sipas specifikimeve të kontraktuara.	Këtë vit nuk janë identifikuar tejkalime të limitit të lejuar.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi, sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet malli/ shërbimi dhe të kryhet pagesa.	Edhe këtë vit janë hasur raste si në vitin e kaluar.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës, që çdo projekt të realizohet brenda kornizës kohore të përcaktuar në kontrata dhe se sigurimi i ekzekutimit duhet të ketë vlefshmëri në raport me periudhën e përmbushjes së kontratës ashtu siç parashihet në ligj.	Edhe këtë vit janë hasur raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që, paraprakisht të eliminohen shkaqet e vonesave të realizimit të projekteve si ato pronësore, si dhe të sigurojë se projektet kapitale buxhetohen me fonde të mjaftueshme për to, me qëllim të realizimit të projekteve sipas planit kohor dinamik.	Edhe këtë vit, janë identifikuar vonesa në realizim të projekteve.	Nuk ka filluar zbatimi

10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët projekteve të kontribuojnë që plani i menaxhimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga palët kontraktuese me qëllim të përmbushjes së detyrave kontraktuale.	Planet e menaxhimit janë nënshkruar nga menaxherët e kontratave.	I zbatuar
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se do të aplikoj ligjin e prokurimit - të inicioj një aktivitet prokurimi vetëm pasi që të ketë kryer një vlerësim formal të nevojave dhe të nënshkruaj një kontratë për projekte kapitale në rastet kur shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim, apo mundësisë së ridestinitimit të mjeteve për projektet kapitale.	Janë ndërmarrë veprime në sigurimin e buxhetit.	I zbatuar
12.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se do të regjistrohen të gjitha pasuritë mbi dhe nën 1000€ në suftueret perkatëse, në mënyrë që vlera e pasurive të prezantohet e plotë dhe e saktë në përputhje me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Pasuritë jofinanciare janë regjistruar në regjistrat e pasurisë.	I zbatuar
13.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë, se janë ndërmarrë veprimet adekuate për një zgjidhje të përbashkët me Agjencionin Kosovar të Privatizimit lidhur me obligimet për Ndërmarrjet Shoqërore nën menaxhimin e tyre dhe ish ndërmarrjeve shoqërore. Po ashtu, të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e të arkëtueshmeve nga të gjithë pronarët e pronave.	Nuk janë hasur raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
14.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave, për të siguruar që Komuna mos të hyjë në obligime pa fonde të mjaftueshme dhe që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor.	Edhe këtë vit kemi vonesa në pagesën e obligimeve.	Nuk ka filluar zbatimimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit



Ilir Abazi, Udhëheqës i ekipit



Arben Hundozi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality of Rahovec

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft - raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komuna e Rahovecit, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm *Raportit*);
- **Pajtohem** me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- Brenda 30 ditësh nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Smajl Latifi,
Zyrtar Kryesor Administrativ
Rahovec, 8.6.2023



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.